INTERVISTË ME MÜRTEZA BÜŞRA

Prishtinë | Data: 16 maj, 2018
Kohëzgjatja: 74 minuta

Të pranishëm:

1. Mürteza Büşra (I intervistuari)
2. Ebru Süleyman (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional
{} - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:
[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e parë

Mürteza Büşra: Unë jam Mürteza Büşra. Büşra, mbiemri jonë [vjen nga] koha kur Komuna e Prishtinës ka lejuar qytetarët t'i ndërrojnë ligjerisht mbiemrat e tyre. Disa nga familjet i ndërruan emrat, mbiemrat dhe babit tim ju është dukur emri i gjyshit të tij i përshtatshëm, pra Büşra. Në fakt, kuptimi i tij është gjithashtu shumë i mirë, Büşra. Büşra do të thotë lumturi, do të thotë të marrësh lajm të mirë. Babi im zgjodhi mbiemër shumë të mirë, ishte ai që e solli.

Tash qyteti ku kam lindur në Prishtinë, në 1946. Babi im ka lindu në Prishtinë rreth 1911 dhe nëna ime gjithashtu rreth 1915. Familja Büşra, do të thotë nëse shkojmë më larg, babai im Süleyman, unë Mürteza, gjyshi im Mürteza gjithashtu. Pse, sepse ishte një traditë në të kaluarën, një zakon për të kujtuar, përsëriteshin emrat e gjyshërve. Nuk ishte ky rasti vetëm në familjën tonë, por edhe shumë familje të tjera e kishin këtë traditë. Për më tepë babi i Büşras, babi më tregonte për të, emri i rij ishte Yusuf dhe babi i Yusufit, ai quhej Hacikardrilar, Hacikadri. Në thelb një kohë, mbiemri jonë ishte Hacikadrilar, një familje që ka vazhduar për tetë gjenerata. Kam fëmijë dhe nipa sot, dhe kur shikon mbrapa, i dijmë emrat e para ardhësve tonë për gjashtë gjenerata.

E sheh, gjyshi ynë Büşra ka punuar në, e dini muzeun sot, rezidencën afër Xhamisë së Çarshisë dhe Xhamisë së Sulltan Muratit, në atë vend gjatë kohës së Osmanëve ai ishte nëpunës, në fakt si arkatar, e kishte një detyrë të tillë. Sigurisht ai e ka marrë pagën në atë kohë, monedha e kohës *akçe* ishte monedhë e vleshme.

Dhe thelbësisht shtëpia jonë është, e dini ku shkolla e mesme e Teknikës është sot, ajo përballë shkollës t'mesme, përpara gjimnazit. Në fakt, objekti që sot quhet ndërtesa arkivore, afër saj ishte një furrë, një tregtar i vjetër që e quanim Ćika Blago [Axha Blago], furra ka qenë e tij dhe afër saj ishin shtëpitë tona. Shtëpitë e ndërtuara një herë e një kohë kishin dyer të mëdha. Të gjitha të mira por kjo shtëpi, shtëpi e vjtër, ndërtesa, shtëpia kishtë oborr përpara and prapa shtëpisë gjithashtu kishte oborr. Shtëpitë e vjetra ishin kështu, shumë të përshtatshme për jetesë. Atëherë, njerëzit gjithashtu mbanin kafshë. Prandaj duhej të kishe një shtëpi me kopshte të mëdha, që të kishe hangar për kafshët. Shportat që përdoreshin për të ushqyer kafshët, furnizimin me ushqim, i quanin kosh, ato shporta.

Natyrisht atëherë çdo familje kishte kopshte dhe fusha gjithashtu. Pastaj prodhimet që ishin rritur në fushë atë vit mbaheshin në shporta ose në podruma të ndërtuar posaçërsiht, do të thotë vendi ku i

mbanin produket për dimër në depo në këto podrume, i quianin *çile.*[1] Madje më kujtohet që shtëpia ishte aq e madhe, lerë se kishe dy kopshte të mëdha, gjithashtu kishte dy podruma. Një bodrum në anën e majtë, një në anën e djathët. Shtëpia ishte shumë e madhe, hyje brenda përmes shkallëve. Nuk ka më shtëpi të drurit të tilla në Prishtinë, tash është shumë e rrallë, në të gjithë Prishtinën janë vetëm tri shtëpi të tilla që janë shëndrraur në muze sot.

Ebru Süleyman: Cilat janë ato? Ku janë? Ndër shtëpitë e vjetra është edhe shtëpia e Hüniler, a po?

Mürteza Büşra: Këto shtëpitë e vjeta, po. Janë tri, të tria janë shëndrruar në muze. Për shembull, tani ne jemi në këtë shtëpi pranë shkollës fillore "Elena Gjika". Ajo që është përballë Sahat Kullës, përballë gjimnazit, i thonim shtëpia e Eşref Kara. E thërrisnim axha Eşref.

Ebru Süleyman: Eşref Kara?

Mürteza Büşra: Eşref Kara, axha Eşref. Kanë migruar në Turki, e kanë lënë shtëpinë, shtetit i'u duk e përshtatshme të bëhet muze. Ishte edhe një tjetër shtëpi ndër shtëpitë e vjetra… Shtëpia e Karabegut, e di ajo rruga përballë gjimnazit që shkon drejtë pazarit, ajo rruga dhe mëhallë quhej *Begler Mahallesi* [Mëhalla e Zotrinjëve] {tregon vendin me duar}.

Dhe brenda, është gjithashtu shtëpia e vjetër e Eminxhikëve. Edhe ato shtëpia u shëndrruan në muze. është muze e jo shtëpi sepse kanë mbetur nga kohët shumë t'vjetra {tregon kalimi e kohës me duar} dhe… në fakt, kur turistët e vizitojnë Prishtinën ata pa dyshim dëshirojnë të vizitojnë njërën nga këto shtëpi. Do të thotë që janë shtëpi historike që kanë mbetur nga koha osmane.

Shtëpia e tretë është, ku jemi tani afër shkollës fillore "Elena Gjika", afër saj janë ato dyert e mëdha, e di? {tregon madhësinë me duar}, shtëpia në të djathët me një oborr të madhd dhe dy kate që shihen, edhe ajo është një ndër shtëpitë që janë shëndrruar në muze. Më të vërtete e mahnitshme...

Ebru Süleyman: Pra shtëpitë e vjetra ishin si këto?

Mürteza Büşra: Në të kaluarën shumë nga familjet e pasura kanë jetuar brenda qytetit. Familjet e pasura gjithashtu kishin kafshë, i mbanin dhe prandaj kishin oborre të mëdha. Shtëpitë me kopshte të mëdha. Në fakt, kur Evliyâ Çelebi[2] e vizitoi Prishtinën dhe Kosovën në atë kohë , a e din çfarë ka thënë? Ka thënë që Prishtina ka shtëpi dhe kopshte të mrekullueshëme. Këtu ishin shtëpi dhe kopshte të mahnitshme. Kopshte të bukura, edhe atëherë bashkëshortet tona, pronarët i jepnin shumë rëndësi kopshteve, u kujdesnin që të kishin lule.

Gjithashtu kishte shumë pemë, gjithmonë i shihje në kopshtet e shtëpive. Kishte edhe shumë larva, pemë si kajsia dhe kumbulla; pemë të rrushit dhe venës gjithashtu gjindeshin në këto kopshte, rreth

[1] *Çile* është një depo e thotë në shtëpitë të stilit osman ku njerëzit thanin dhe ruanin ushqimet për një kohë më të gjatë.
[2] Evliyâ Çelebi është një udhëtar i shekullit të 17. Ai ka kalur më shumë se pesëdhjetë vjet duke udhëtuar tokat osmane dhe të tjera. Ai ka mbledhur eksperiencat e tij në librin e tij të udhëtimeve *Seyahatnâme*.

vendeve ku jetonin njerëzit. Kishin shtëpi të tilla. (Buzëqeshë) çfarë tha Evliyâ Çelebi, kjo është përcjellur nga gjenerata në gjeneratë, shtëpitë ishin aq të bukura sa që, në thelb ai duhej të regjistronte artefaktet osmane në ditarin e tij të udhëtimit. Ai ka shkruar për dy ose tri nga xhamiat dhe ishte ai ishte aq i çuditur dhe i mbreslënë nga peisazhi sa që filloi ta përshruante bukurinë e oborreve, luleve, dhe kopshtëve.

Më vonë, për shembull, ishin gjashtë shkenctarë që erdhën [në Prishtinë]. Ata i shikuan dhe i vizituan vendet historike në Kosovë detajisht, kanë hulumtuar. U ndalën edhe në Prishtinë, atëherë. është thënë që Prishtina ka tri xhami atëherë, që kanë mbetur nga koha e osmanëve. Sigurisht as një nga ato tri xhami nuk i rindetuan pasi që u rrëzuan.

Gjatë kohës tonë, rreth vitit 1952, në lagjën që ne i them Llokaq, pjesa qëndrore e qytetit, tash Nëna Terezë, a shohim një shatërvan. Ajo tregon që nja xhami ka qenë afër tij. Tamam ajo xhami është rëzzuar në vitin 1952 dhe krejt çka ka mbetur [është ai shatërvan]. Kur u rrëzua, të gjithë menduan që ishte urdhër nga shteti. Në vitin 1955 çka do që ka qenë ë vjetër në pjesën qëndrore është rrënuar dhe diçka e re është ndëruar në vend të saj, sepse ajo ishte pjesa qëndrore e Prishtinës dhe në fakt, ishte premtuar që ajo xhami të ndërtohej në një pjesë tjetër të qytetit por ai premtim nuk u mbajt kurrë.

Ebru Süleyman: Ty të kujtohet kjo xhami?

Mürteza Büşra: Po sepse e sheh, babi im ka mbetur jetim, kur ishte fëmijë. Mendoj diku rreth vitit 1919, një sëmundje shumë e rendë e quajtur kolera u përhap në qytet dhe e goditi aq fortë sa që shumë qytetarë të Prishtinës e humbën jetën në atë kohë.

Ebru Süleyman: Babai i… Gjyshi juaj...

Mürteza Büşra: Babai i babait tim, do të thotë gjyshi i familjës Mürteza, dy nga djemët e tij dhe ai e humbën jetën nga kjo sëmundje. Do të thotë ka qenë një sëmundje e rrezikshme, kolera, ishte e ngjashme me tifon. Tifodi është një sëmundje tjetër shumë e rrezikshme që e goditi Prishtinën, më vonë, në vitin 1971. Pra në të kaluarën, Prishtina ishte gotidur nga dy sëmundje pandemike, edhe nga tifo, edhe nga kolera. Normal, më herët ishte një sëmundje më e rrezikshme, një sëmundje që është quajtur murtaja. Ishte shumë e rrezikshme, por kolera ishte e rrezikshme gjithashtu.

Tani, pse jam duke ta treguar këtë, në mesin e anëtarëve të familjës tonë, babai i babait tim, gjyshi im e humbi jetën, gjithashtu edhe gjyshja ime dhe dy djemët e tyre. Babai im ishte djali i tretë dhe organizmi i tij ishte rezistent dhe kështu i mbijetoi sëmundjës. Por për shkak se ishte jetim, axha i babait e ka rritur atë. Axha i tij u kujdes për të, e ka rritur. Axha i tij ishte hoxhë, në Xhaminë e Çarshidë, *Taş Camisi* [Xhamia e Gurit]. Xhamia e Sulltan Muratit po thërritet me tre emra të ndryshëm. Epo, Xhamia e Çarshisë, ne themi Xhamia e Gurit, Djali i Sulltan Muratit Beyazid, Xhamia e Beyazidit gjithashtu është një nga emrat qe natyrisht ju është dedikuar Sulltan Muratit nga djali i tij, Beyazid.

Beyazid e dini gjatë kryqëzatës të parë, gjatë kohës së Osmanëve, gjatë sundimit të Sulltan Muratit pas një lufte filluan të ndërtojnë xhamia për shkak të fluksit nga Anatolia për këtu. Gjahtë asaj kohe, jo

vetëm xhamiat por kishte edhe artefakte të tjera arkitekturore që janë ndëruar në kohën e osmanëve, gjithashtu ishin edhe hamamet. Në fakt, si për traditë hamamet janë ndërutar para se të mbaronte ndërtimi i xhamive.

Përveç këtyre, kishte gjithashtu ura. Prishtina kishte ura. E sheh, dy lumenjë kanë rrjedhur nëpër Prishtinë. Njëri quhej Vellusha dhe tjetri Prishtevka. Këta lumenjë dhe ujrat e tyre të mira ishin perlat e Prishtinës. Te gjitha mirë, po ndonjherë kanë bërë edhe keq, kemi parë edhe që kanë bërë dëm. Ndonjëherë, pasi që binte shumë shi, ata e përmbytnin Prishtinën, bregjet e lumenjëve. Përmbytja i prekte edhe shtëpitë afër bregjeve të lumenjëve, i dëmtonte. Ka gjithashtu edhe lumenjë tjerë në Kosovë që bënin dëme të tilla, për shembull, Drini në Prizren, shkaktonte fatkeqësi kur dilte nga shtrati dhe qyteti përmbytej.

E njejta situatë edhe në Mitrovicë, lumi Ibër. Ata dy lumenjë në Prishtinën u bashkonin afër stadionit të futbollit sot, e dini stadioni i futbollit i Prishtinës sot… Aftër stadionit të rinisë, bahkohen me Sitnicën, pastaj (e pakupt.), do të thotë në Fushë Kosovë. Fushë Kosovë dhe pas Sitnicës lumi i Llapit, lumi rrjedhë në lumin e Llapit. Dhe siç e dini pas lumit të Llapit rrjedhë gjatë deri në Moravë, uji shpërndahet në Serbi pas asaj.

Tani, kam folur për familjën time por nëse keni dëshirë mund të flasim për vende të tjera historike në Prishtinë gjithashtu.

Ebru Süleyman: Si të duash. Nëse doni mund të më tregoni për kujtimet nga fëmijëria jote dhe vendet historike në Prishtinë që i dini...

Mürteza Büşra: Ah dhe pastaj shtëpia jonë, që të kam treguar që është ndërtuar në *Mektepler Mahallesi* [Lagjën e shkollave]. Në fakt, pasi u rrënua shtëpia jonë një shkollë u ndërtua në vend të saj, shkolla e mesme teknike. U bë shkollë. Tani në atë lagje kishte edhe shatërvane. Shatërvanet, kisha mësuar që këto kur isha duke u marrur me gazetari duke folur me të vjetrit e asaj kohe. Nëse pyetni vetën sa shatërvane kanë qenë në Prishtinë, tani e dijmë numrin e xhamive, por edhe shatërvane kishte shumë. Prishtina kishte gjashtëdhjetë shtërvane. Sot lehtë i dijmë emrat e 45-46 prej tyre, i dijmë emrat. Dhe kemi mledhur, përpiluar këto të dhëna shumë, për shembull, kemi shkruar për to në gazeta dhe revista.

Shkenctarët që mirreshin me shkencë kanë shkruar për këto artefakte në punën e tyre, i kanë inçizuar të gjithë artefaktet tona. Ka edhe përpilime të librave për artefaktet osmane të shkruara nga gjashtë shkenctarë. Tani, nga të parat sigurisht Sami Frashëri, e kemi një shkollë në emër të tij, në kohën e tij, një shkenctar i dytë ka folur për Prishtinën në punën e tij gjatë asaj kohe gjithashtu. E ka pasur një vepër që është njohur si *Kamûs-ı* thuhet se ai ka përmendur [Prishtiën] aty. Dhe n fakt i pari që ka folur për Prishtinën është Evliyâ Çelebi. *Seyahatname* [Libri i udhërtimeve] i tij, e di ai, ai ka udhëtuar shumë, të gjithë botën, dhe ka qenë në të tre kontinetet që osmanët sundonin në atë kohë.

Një shkenctar i tretë, prapë nga Turkia, një shkenctar i njohur me emrin Ekrem Ayverdi, erdhi, i ka numruar dhe inçizuar artefaktet një nga një, si inxhinier, si shkenctar. Bashkë me këta prapë

shkenctarë nga Prishtina kanë dalur nga universiteti jonë, shkenctarë si Hasan Kaleshi, Riza, doktori Riza, Iskender Riza dhe Zoti Raif, Raif Vırmiça që jeton në Prishtinë dhe që ka qenë drejtori i gazetës *Tan*, ai i ka analizuar materialet e mbledhura dhe i ka mbledhur inçizimet shkencore deri në atë kohë në një vend, dhe e ka votuar si libër. Dhe sot kush do që dëshiron lehtësisht mund të e gjej librin e Raif Vırmiçës dhe të lexoj për to.

Ebru Süleyman: Është për Prishtinën?

Mürteza Büşra: Po. Përveç shatërvaneve, shumë artefakte tjera kanë mbijetuar deri sot. E di është Sahat Kulla, shkolla e mesme, ende është në oborrin e shkollës Sami Frashëri. Është Sahat Kulla e cila është gati treqind vjet e vjetër. Për shembull, ka një hisotri, Sahat Kulla. Tani, është ndëruar nga pronarët e shtetit, Sahat Kulla. E shihni, nuk ishte ndërtuar mirë, nuk punonte mirë dhe prishej shumë shpesh, nuk punonte shpesh. Dhe tani (e pakupt.) ora shumë e shtrenjtë në atë kohë, për të ndërtuar një ora të madhe {tregon madhësinë me duar} të tillë për Sahat Kullën duhet edhe para, edhe punëtorë të mirë.

Tani çfarë kanë bërë, dhe ky është supozim, nuk e di nëse është e vërtetë apo jo por nëse është e vërtetë atëherë është shumë qesharaka. Dhe çfarë është bërë, e dini në Vushtrri është një Sahat Kullë e ngjashme me këtë, ajo është ndëruar rreth dyqind vite më parë, rreth treqind viteve më parë orat ndëtoheshin në Çekosllovaki, e di çekët ishin shumë të civilizuar dhe tekonologjia e tyre ishte realivisht më e përparuar. Ora sigurohej, merrej nga atje. Qe do të thotë ora blihej atje për të gjitha vendet ku kishte ora, Sahat Kulla, e dije qe orat janë prodhuar, janë bërë nga çekët.

Tani, ka një histori që tregohet, një anekdotë në lidhje me këtë Sahatkullën. Ju tregova që ajo prishej shumë shpesh dhe Vushtrria e kishte një sahat të ngjashëm me këtë, mirëpo punonte shumë më mirë se kjo, tani ata menduan si t'ia bëjnë… Shkuan atje dhe u thanë, "Shikoni, Prishtina është një vend qendror, është qendra e sanxhakut do të ishte mirë nëse do të na jepnit sahatin". Ata dyshuan se nuk do të jepnin sahatin. Çfarë duhet të bëjmë atëherë, si do ta marrim sahatin tani, si mund t'i mashtrojmë njerëzit nga Vushtrria. Ata morën disa qenjë, ata që lehnin shumë dhe i kanë lidhur disa kanaqe në bishtin e tyre që të bëjnë zhurmë {bënë sikur lidhë me duar} dhe ashtu i lëshuan ata…

Ebru Süleyman: I kanë lëshuar.

Mürteza Büşra: Aty rreth Sahatkullës. Artizanët, qytetarët shikonin përreth dhe pyesin veten se çfarë po bënte kaq shumë zhurmë, kjo tërhoqi interesin e tyre, zhurmat e mëdha që qentë po bënin. Pas kësaj, ju keni ndëgjuar për vjedhësin Mehmet Aga, një hajdut që ishte virtuoz shumë i aftë, ju e dini. Një grup i të rinjve, si ky hajduti, shkoi në Sahatkullë, hoqi sahatin në Vushtrri dhe qytetarët e Vushtrrisë kurrë nuk e kuptuan as nuk e dinin. Ata morën sahatin dhe e vendosën atë në Prishtinë në vend të asaj të vjetrës. Megjithatë, pas një kohe ata e kuptuan se sahati ishte tjetër, ndoshta ata mund ta kishin zbuluar edhe e kanë kuptuar se si ndodhi e tëra. Shikoni çfarë plani i plaçkitjes! Do të thotë, për hir të qytetit tënd, për të parë qytetin tuaj më mirë, çfarë nuk kanë bërë njerëzit për të, apo jo? (qeshë)

Në fakt, xhamiat, mahallat e vjtera, dhe rrugët duhet të kena legjenda urbane të tilla gjithashtu por nëse dëshironi këtë herë mund të flasim se cilat rrugë dhe mëhalla të vjetra ekzistonin, si quheshin. Për shembull, në qendër që tani e quajm Nëna Terezë, duke filluar nga ndërtesa e parlamentit nga xhamia e Çarshisë deri te Grandi, ajo lagje, ajo lagje quhej Llokaç. Llokaçi, është një thënje qesharake për këtë. Kishte rënë shumë shi dhe kalldërmet e vjetra, sado të mira që ishin, bënin shumë baltë, pisllëk, nuk mund ta hiqje. Dhe një njeri i lodhur e tha i pari me siguri dhe u shpërnda, dhe zanatlinjët thonin, "*bak bu da Llokaç, tükür de kaç"* [e sheh ky është Llokaçi, pështyje dhe vrapo] një thënje e tillë… (qeshë).

Ebru Süleyman: Si fjalëshpejtë?

Mürteza Büşra: Ndoshta si idiomë, e kanë thënë një idiomë të tillë. Ndërsa sot, lagjia e Llokaçit është një ndër lagjet më të bukura të Prishtinës, apo jo? është një lagje e shkëlqyer në zonën qendrore, ndër më të mirat. Përveç kësaj, atëherë në kohën e gjyshërve tanë, paraardhësve tanë, ishte një lagje që quhej Tophane. Gjatë muajve të Ramazanit dhe gjatë festave religjioze në fund të ditës shtihej me top në Tophane. Aty e ka marrur emrin Tophane. Pas kësaj rrugë të tjera të rëndësishme, fillimisht Prishtina përbëhej nga katër {tregon katër me gishta} lagje. Njëra nga këto Llokaçi, tjera Tophanja, dhe e treta quhej Varosh, e di lagjia e shkollave që e përmenda, lagjia ku ishte shkolla fillore dhe e mesme. Kjo pjesë quhej Varosh, e di, përveç shkollave, e gjithë ajo pjesë quhej Varosh.

Ebru Süleyman: Deri ku zgjatej?

Mürteza Büşra: Pra pjesa e Varoshit, atëhere Prishtina ishte e vogël, sa e madhe mund të thuash se ishte, pesëdhjetë deri në njëqind metra e gjatë. Dhe më kujtohet, për shembull, babai im dhe gjyshi im tregonin këtë gjithashtu, në atë rruga në anën e dhjathë {tregon anën e djathtë} rrugët e serbëve, rrugët e komunitetit serb. Shtëpitë e tyre në anën e djathtë dhe muslimanët e kishin anën tjetër {tregon anën e majtë}. Në fakt, popullata ka qenë e ndarë në dysh, muslimanët dhe jo muslimanët, do të thotë komunitetet krishtere, ortodokse, hebreje që konsideroheshin si qytetar jo musliman. Përveç këtyre mëhallava dhe rrugëve, një rrugë tjetër në qytet që më kapi syrin quhej Pirinaz.

Ebru Süleyman: Pirinaz?

Mürteza Büşra: Nëse ndalon dhe shikon në çdo rrugë, dhe sigurisht janë rreth dhjetë-pesëmbëdhjetë rrugë, në çdo rrugë është ndonjë artefakt i çmueshëm, si xhami, *masjid*, po. Prishtina kishte tre hamame. E di, kur të pyetnin, "Nga je?", "Nga Prishtina". "Nga cila lagje?"; dhe thoje ndonjërën nga këto katër lagje, ose ndonjë verzion të tyre, për shembull, "Jam nga lagjia e xhamisë të Çarshisë", "Jam nga lagjia e xhamisë së Sulltan Muratit", ose në këtë rast, lagjia gjithashtu mban emrin e xhamisë, Pirinaz.

Ebru Süleyman: Cila është xhamia Pirinaz?

Mürteza Büşra: Pirinaz, e dini rrugën drejtë Taukbashçës. Tani aty është shkolla, nëse e ndjekë Vellushën deri kur jeni afër Taukbashçës, në anën e majtë.

Ebru Süleyman: Gjatë rrugës ku është Medrezja tani?

Mürteza Büşra: Po kjo Medrezja në Vellushë, në rrugë në të majt e shihje [xhaminë].

Ebru Süleyman: Pra rruga atje, zonë e banuar.

Mürteza Büşra: Xhamia Pirinaz. Dhe tani një xhami tjetër tek e cila të dërgon Vellusha është Xhamia e Emir Aladinit. Kjo Medrezja përpara nesh tani e di, kjo lagje në lagjën e shkollave {tregon atë zonë me duar} Medrezja është gjithashtu shumë afër kësaj lagje. Ajo është shkolla ku njerëzit merrnin edukim teologjik, shkolloheshin *hafız*[3]*,* studentët edukoheshin.

Në fakt, ndonjëherë si shaka, babai im thoshte mësuesitë tanë nuk ishin si mësuesit e juaj, ata tani kanë një shkop të vogël dhe goditnin fëmijët që nuk silleshin mirë, me qëllimin që të mësonin sjellje të mira. Ndërsa mësuesin tanë kishin një shkop nga një anë në anën tjetër {tregon me duar} duke filluar nga tre metra, ata i frikësonin fëmijët, i bënin të fokusoheshin në punë, duke i qortuar që të lexojnë dhe të mësojën, për të siguruar diciplinë.

Tani, kemi folur për lagjën Tophane, Pirinaz dhe gjithashtu ishte një [lagje] Gümrükhane[4]. Gümrükhane, e dini në hymje të Prishtinës.

Ebru Süleyman: Ku është tani?

Mürteza Büşra: Gümrükhane ishte aty ku kampusi univerzitar është sot, nëse e di shkollën pedagogjike, fakultetin pedagogjik këtu, Prishtina zgjerohej vetëm dery aty atëherë.

Ebru Süleyman: Pra ajo ishte hyrja e qytetit?

Mürteza Büşra: Po, lidhej me lagjën e Muhaxherëve, mbrapa teatrit rruga që tani quhet Agim Ramadani. E dini atë rrugën që është mbrapa teatrit , gjithashtu quhej rruga e osmanëve. Pas osmanëve, lagjia Gümrükhane dhe në të majtë ishte mahalla e Muhaxherëve. Rruga që të dërgonte në lagjën e Muhaxherëve. Lagjia e Muhaxherëve ka ekzistuar në shumë lagjë në fakt. Lëvizjet e njerëzve pas luftës i krijuan këto mahalla sepse komunitete të njerëzve vendoseshin vë qytetin më të afërt të banueshëm që kshin. Edhe Prishtina ka një lagje të tillë.

Përveç këtyre, njëra nga rrugët më të rëndësishme të qytetit është rruga Divan Jolli. E di rruga Divan Jolli në Prishtinë që fillon nga xhamia e Sulltan Muratit, rruga drejtë që zgjatet deri në Dragodan. Pse quhej Divan Jolli, sepse ishte aq e drejtë, një inxhiner bashkëkohor nuk mund ta bëjë aq të drejtë , kështu mburreshin njerëzit nga Prishtina. Sepse ishte e drejtë dhe e gjatë si *divan* [krevat] dhe e

[3] *Hafız* bukvalisht do të thotë ai që mbron, ai që ruan. Personi që e di gjithë Kuranin përmendësh quhet *Hafız.* Në traditën islame, thuhet se ata kanë ndihmuar të ruajnë formën origjinale të Kuranit duke e mësuar përmendësh.
[4] *Gümrükhane* (Turqisht) që do të thotë Dogana. Lagjia në Prishtinë që kishte këtë emër konsiderohej hyrja e qytetit, veçanërisht për mallrat tregtare qw arrinin në Prishtinë gjatë sundimit osman.

emëruan ashtu. Dhe rruga e parë përpara përpara komunës sot, *Bitli Sokak* [Rruga e pazarit], quhej ashtu. Pse pazar, sepse, e di *Bit Pazar* në Shkup, tekstili, rrobat, gjëra të dorës së dytë shiten aty...

Ebru Süleyman: Pra do të thuash rruga?

Mürteza Büşra: Rruga e parë para komunës, e di rruga ku xhamia e Sudi Efendisë është, i pari *Bitli Sokak,* pse, sepse një pazar ishte aty. Jo gjëra drejtë nga fabrika, por gjëra së dorës së dytë që kanë shkuar nga një pronar në tjetrin shiteshin aty. Njerëzit nuk kishin shumë, varfëri, një kohë kishe varfëri, njerëzit nuk mund të gjenin rroba dhe pëlhura dhe këto gjëra shiteshin në pazar.

Ebru Süleyman: Efektet e luftrave botërore?

Mürteza Büşra: Po.

Ebru Süleyman: The që gjithashu kishte edhe sëmundje epidemike?

Mürteza Büşra: Sigurisht, Prishtina u përfshi nga dy sëmundje infektuese që shkatërruan komunitetin. Do të thotë, shumë njerëz humbën jetët, vdiqën. Edhe nga familja ime, që të tregova, [sëmundjet] prekën gati gjysmën e popullatës. Ishin gjtihashtu edhe dy zjarre të mëdha. Zjarret ishin ishin të mëdha sepse dyqanet dhe shtëpitë ishin shumica të drurit dhe e dini që janë të prekshmë nga zjarri. Nëse i kap zjarrin menjëherë bëhen hi. Kur shikoje qindra shtëpi u bënë hi nga zjarri në një shtëpi, ishte një ngjarje e dhimbshme për njerëzit, zanatlinjët.

U bë një tërrmet, ndodhi dy herë. Ishte një që është treguar nga një gjeneratë në tjetrën që ka ndodhur diku rreth vitit 1707, një ngjarje që të copëton zemrën, tërrmet i madh. Disa vite më pas u përsërit, një tërrmet tjetër dhe Prishtina u prek shumë, shkatërroi shumë… Këto rrugë dhe mahalla tërheqin më së shumti vëmendje.

Ebru Süleyman: Divan Jolli kishte zanatlinjë dhe pazar.

Mürteza Büşra: Ah tani, shumë e vërtetë, ma kujtove, për shembull, më kujtohet ajo rrugë pakëz, disa e thërritnin *Kapali Çarşi* [Pazari i mbyllur] tani por në fakt, queht *Ürtüli Çarşi* [Pazari i mbuluar]. Çfarë ishte e mbuluar? Ishte një magazinë e mbulur deri diku dhe kishte pemë pranë, rrush dhe shumë pemë akacie, gjithashtu disa pemë lindore. Në disa vende, pazari ishte i mbuluar me degë dhe gjethe të këtyre pemëve, dhe prandaj quhej pazari i mbuluar. Por pazari më i madh për zanatlinjët ishte ky vend.

Madje më kujtohet fëmijëria ime atje sepse babai im punonte në një dyqan të zanatit saraçi. Kur isha fëmijë, shkoja atje ta shihja dhe më vonë fillova të punoj si nxënës aty. Sigurisht, na jepnin vetëm detyra të lehta, thoshte, “Bëjë penjët”. Penjët duhej të bëheshin sepse ishte punë e qepjes më së shumti, saraçët bënin rrethe, shala për kuajt dhe kafshët.

Saraçët bënin këto gjëra, gjithashtu bënin edhe sandalle. Mjetet e nevojshme, themelore për të qepur ishin penjët. Por penjët duhej të bëheshin mirë dhe të fortë, duhej zanat, ata na përdornin neve për atë. Kur isha fëmijë kryepunëtori na thoshte, "Ju bëni penjët, duart e juaja janë shumë të përshtatshme për atë". Më kujtohet që bëja penjët. Pra kështu, e ndihmoja babain atëherë. Sigurisht, disa profesione të vjetra kështu shuhen gjatë kohën kur teknologjia avansohet.

E shihni, kafshët janë përdorur dhe shfrytëzuar vetëm deri në një pikë të caktuar. Atëherë, të mbaje kafshë brenda qytetit ishte e ndaluar. Një urdhër erdhi që të largohen kafshët nga qyteti, pse, sepse bënin dëm. Së pari kërkojnë shumë punë, është e pamundur ta bash shtëpinë plotësisht të pastër kur ke kafshë, andej, edhe shkaktojnë sëmundje. Sepse tifo mund të shfaqet nga situata kur kafshët mbahen në shtëpi, bakteret rritën dhe sjellin sëmundjen. Pra është në fakt mirë që i larguan nga Prishtina dhe erdhi ai urdhër. Pas asaj qyteti jonë, qyteti jonë që nga atëherë nuk u godit nga as një sëmundje në shkallë të lartë.

Ebru Süleyman: Përveç saraçinjëave, çfarë profesione tjera nuk ekzistojnë më?

Mürteza Büşra: Për shembull, babi im pasi që zanati i saraçit u shua, e dini një pjesë e zanateve të vjetra u shuan. Teknologjia e re, kur veturat dhe makinat e reja u shfaqën jeta ndryshoi, transporti ndryshoi atëherë veturat përdoreshin për transport.

Ebru Süleyman: Përgjatë fëmijërisë suaj, transporti bëhej me pajtonë apo?

Mürteza Büşra: Me pajtonë, për shembull kur nëna ime vizitonte dajtë e mi, dajtë jetonin në Llokaç. E dini këtë Zotni Shabanin sot, ai vendi i kebapit, mu aty ne kishim shtëpinë e vjetër, andaj konsiderohej e turpshme për nënën time të ecte nga lagjja e shkollës deri aty në këmbë me fëmijë. Sikurse sot si i përdorim taksitë kur shkojmë në vizita, pajtonët përdoreshin ashtu dhe përmes Divan Jollit shkonim tek Llokaçi. Më kujtohet shumë mirë.

Por ashtu siç shuhen profesionet e vjetra, të rejat vijnë e shfaqen. Për shembull, çka kishte me qenë një profesion që mund të konsiderohet i afërt me atë të babait tim është punimi i mobileve, puna me ulëse. Çfarë sot ne i quajmë kauça. Për herë të parë në Prishtinë ky profesion u krijua dikur rreth vitit 1955, '56-tën kur mjeshtrit nga Beogradi erdhën dhe na e mësuan.

Saraçët janë ndryshe, produkti është ndryshe dhe punimi i mobileve është ndryshe, kërkon materiale të tjera, tjetër mjeshtëri, andaj të nevojitet përvojë për këtë, ta ndjekësh ndonjë kurs apo të mbledhësh dije ta mësoje veten.

Mjeshtrit arritën nga Beogradi dhe u vendosën në dalje të Prishtinës, në rrugën për Fushë Kosovë, në anën e djathtë të rrugës u ndërtua një fabrikë që quhej "Napredak". Ishte një ndër fabrikat e para. Tash me të, në vend të kauçave të vjetër në shtëpitë tona të vjetra, tani kishim kauça, ishte modë në atë kohë dhe tash ishte krijuar si profesion. Dhe përmes atyre mjershtërve, babai im mori edhe një profesion, një që ishte i afërt me saraçët. Ai e njihte aspektin e qepjes. Natyrisht edhe mveshja ishte e

përafërt dhe për një kohë të shkurtër saraçët, mjeshtrit dhe shëgërtat u bënë punëtorë në fabrikë, pra të aftë për të prodhuar kauça.

Dhe ata bënë kauça dhe divane aq të qëndrueshme saqë janë shitur mjaft gjerësisht në Kosovë dhe janë eksportuar gjithashtu jashtë Kosovës. Në atë kohë ndoshta kauçët janë dukur më thjesht por ju është përkushtuar shumë punë. Më kujtohet kur i ndihmoja babait për të bërë kauça, ne vendosnim spango në kauça dhe ato shtrëngoheshin (pa dëgju.) me vida dhe pastaj kalonin në punën me qepje, peri shtrëngohej aq shumë. Me sa duket, ishin dy stile të ndryshme për t'i lidhur njëri stil ishte francez dhe tjetri ishte stili gjerman. Ai në stilin gjerman ishte kështu {tregon gjeste me duar} me siguri mjeshtri që ka ardhur nga Gjermania, spangot lidheshin dhe nuk lëviznin fare. Pastaj, mbushej me diçka që quhej alga, më shumë me këtë se sa me sfungjerë që përdoren sot.

Kauçët që janë bërë nga sfungjeri janë pak të dëmshme, profesionistët mjeksor pretendojnë kështu. Kurse ato që janë të mbushura me alga nuk janë, në fund të fundit, është diçka që rritet në natyrë, diçka nga deti që kemi dobi. Kauçët ishin aq të fortë sa që kauçi që e kam bërë me babain para pesëdhjetë viteve ende qëndron, mendon që është bërë dje, sot. Kauçët sot janë të ndërtuar nga sfungjeri siç është në modë por me ndryshimin e modës ndryshon edhe biznesi. Këto ditë çdonjëri zgjedh opsionin më të thjeshtë, ato spangot e forta nuk përdoren më, nuk lidhen si dikur dhe krejt çka një kauç ka është ai lloji i veçantë i sfungjerit shkumë. Ky zanat është bërë profesion sot.

Ebru Süleyman: Dhe përveç saraçëve?

Mürteza Büşra: Përveç saraçëve, për shembull, mund të flasim për zanatin e sahatçinjëve, nëse e mendojmë ka ende njerëz që e vazhdojnë zanatin që e kanë mësuar nga baballarët dhe gjyshërit e tyre në Prishtinë, për shembull shoku im Faruk Pandukli, ai e ka dyqanin para Grand Hotelit, është njëri nga dyqanët më të vjetër në qytet. Babai apo gjyshi i tij ka qenë sahatçi dhe ai e vazhdon zanatin e njejtë duke u bazuar në dijen që e ka marrë nga ata. Tani teknologjia e re është aq efektive që fabrika po ndërtohen dhe orët gjithashtu po bëhen në ato fabrika, apo jo? Dhe pasi që ato po prodhohen në masa, profesionet e vjetra dhe zanatet po shuhen dhe po e humbin vlerën. Pra, ju e shikoni se si këto zanate po zhduken një nga një kur tani po ndërtohen fabrikat, dhe tani i rregullojnë orët e vjetra.

Për shembull, sot edhe ne mund t'i riparojmë kauçat e vjetër nëse kanë ndonjë defekt apo duhet të renovohen, ne i renovojmë. Disa zanate shuhen dhe disa profesione marrin jetë me teknologjinë e re. E shihni, shumë zanate si kjo zhduken. Kur unë merresha me gazetari, u bëra kurioz për këtë dhe shkova në Shkup sepse Shkupi ka numër më të madh të tregtarëve dhe tregut, njerëz më të pasur që merreshin me tregti. I pyesja të moshuarit për zanatet e vjetra që nuk ekzistojnë më, cilat kanë qenë ato. Ata mi numëronin më shumë se tridhjetë profesione. Tani nëntëdhjetë përqind prej tyre nuk ekzistojnë më. Duhet t'i përshtatemi botës bashkëkohore, apo jo?

Çfarë nuk ka sjellë teknologjia e re? Për shembull, ka pasur magnetofon, telefona, telefoni ka një histori të gjatë dhe të kaluar, telegrafi gjithashtu. E sheh, ne tani i përdorim telefonat, që janë shumë modern. Esencialisht modelet më të reja janë më të mira, imagjino sot mund të mbledhësh dituri përmes laptopit, mund të punosh me të, të lexosh në të. Janë shpikur telefonat, i shikon dhe pas një

kohë kanë kompjutera brenda telefonit, që do të thotë se të gjitha shkencat në botë po përparojnë, shikoni në çfarë niveli kanë arritur. Me teknologji bashkëkohore sot ju keni telefon në dorën tuaj dhe një dije të pakufishme për botën në pëllëmbën tuaj.

Tani, çka tjetër ndikohet, sigurisht botimi i librave ndikohet, ndoshta zakoni i fëmijëve për të lexuar libra do të jetë diçka e të kaluarës por shpresoj që nuk do të zgjas gjatë dhe zakonet e vjetra do të mbesin. Sepse ndoshta ritmi i marrjes së njohurive të tilla mund të jetë i dëmshëm. Ndoshta marrja e njohurive si më parë, nga libri, shkrimi në letër do të ishte më i dobishëm. Pra… Ja ku është…

Ebru Süleyman: Xhaxhi Mürteza ju kujtohet Divan Jolli i qytetit atëherë? Ju thatë që ju kujtohet tregu i mbyllur…

Mürteza Büşra: Po, unë pothuajse u rrita aty, në tregun e mbyllur, kishte shumë zanate…

Ebru Süleyman: A ju kujtohet kush jetonte në qytet? Çfarë gjuhë i dëgjonit në rrugë?

Mürteza Büşra: Eh mirë… Ju thash që nëse kthehemi shumë mbrapa populllsia ka qenë e ndarë në dy. Ata thoshin muslimanët dhe jo muslimanët, kurse në kohën e re të Jugosllavisë, për shembull kur osmanët janë larguar ky vend ka pësuar mjaft fatkeqësi, luftërat e ballkanike, filluan rreth viteve ‘11 apo ‘12. Në vitin 1913 është Lufta e Dytë Ballkanike, një tjetër shkatërrim dhe Prishtina ka pësuar mjaft, ka kaluar ditë të dhimbshme… Kanë ndodhur ngjarje të dhimbshme, a mund të zhvillohet një populllsi e qytetit menjëherë pas luftës? Duhet ta filloj jetën nga zeroja prapë. Po ju them fatin e Prishtinës, sikur edhe të shumë qyteteve tjera. Por pse pikërisht Prishtina, sepse Kosova ishte një urë lidhëse ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë, e shihni, nëse dikush dëshiron të shkoj në jug duhet të kaloj këndej. Ky është një vendkalim dhe prandaj Kosova i ka pësuar disa fatkeqësi, menjëherë pas luftërave ballkanike ndodh Lufta Botërore fatkeqe. Lufta e Parë Botërore zgjat katër vite nga 1914 deri 1918, çfarë ndodh pastaj? Qyteti shndërrohet në gërmadhë.

Pjesa e dytë

Mürteza Büşra: Gërmadhat, kohërat e këqija, të gjesh bukë ishte e vështirë. Si të kultivoje produkte, çfarë do të mbillje, çfarë do të bëje? Shndërrohet në gërmadhë. Lufta… Zhvillimi pas luftës është shumë i vështirë. Gjithashtu mund të sjell edhe sëmundje, gjithçka, gjëra të ndryshme të dëmshme. Por në 1918 Jugosllavia u formua për herë të parë. Në kohë të mëparshme, e dini organizatën e Kombeve të Bashkuara që sot e kemi, atëherë e kishin Kongresin e Berlinit. Çështjet e botës formoheshin duke u bazuar në vendimet që merreshin në Berlin. Pra duke u bazuar në një vendim, Jugosllavia duhej të formohej për herë të parë, do të thotë pas 1918 kur u formua Jugosllavia, i kishte tri gjuhë zyrtare serbishten, kroatishten dhe gjuhën sllovene. Që do të thotë gjuha zyrtare dhe administrata do të ishte nën këto tri kombet.

Sidoqoftë, Jugosllavia kishte edhe tetëmbëdhjetë kombe të tjera që jetonin në të. Ndoshta kishin të drejta njerëzore deri në një shkallë por të drejta ligjore nuk kishin. Do të thotë vetëm serbët kishin të

drejta legjislative dhe ata e sunduan Jugosllavinë. Sidoqoftë, në kohë e shikoni periudhën e [Jugosllave] Mbretërisë, sa vite zgjat? Të '18-tat, të '20-tat deri tek të '40-tat, rreth njëzet vite. Pas njëzet viteve edhe shoqëria fillon të ndryshoj, është lufta tjetër, Lufta e Dytë Botërore, kjo gjithashtu zgjat katër-pesë vite. Përveç këtyre qyteti ka pasur mjaft shkatërrime të tilla…

Ebru Süleyman: A ju kujtohen migrimet?

Mürteza Büşra: Migrimet janë bërë nga Lufta e Parë Botërore deri në Luftën e Dytë Botërore. Për shembull, përveç serbëve, turqit dhe shqiptarët jetonin gjithashtu në këtë pjesë, do të thotë në Kosovë dhe në Prishtinë. Përveç kësaj, kishte edhe minoritete të tjera. Për shembull, kam dëgjuar nga më të moshuarit që kishte madje edhe armenë [që jetonin këtu]. Të moshuarit tregonin, armenët, grekët, bullgarët, maqedonët, hebrenjtë, romët [jetonin këtu]. Romët gjithashtu kishin komunitete muslimane dhe jo muslimane në qytet. Dhe popullata përbëhej nga këto komunitetet. Eh dhe, edhe pse janë bërë disa reforma gjatë periudhës së Mbretërisë, të drejtat njerëzore nuk përparuan aq. Për shembull, do t'i gëzoje të drejtat ligjore vetëm nëse ishe serb, kroat apo slloven, sidoqoftë, minoritetet tjera nuk i kishin këto të drejta.

Por ka shumë ndryshime pas Luftës së Dytë Botërore. Është pastaj vazhdimi i shtetit federal, por në një mjedis socialist. Një rend i ri vjen dhe sigurisht, jeta është ndryshe në rendin e ri, është më e mirë, është brenda vëllazërisë dhe unitetit. Dhe pastaj, shteti federal përbëhet prej republikave, Jugosllavia e dytë. Sa shtete janë në federatë: duke filluar nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Serbia i ka dy pjesë që bëhen më vonë krahina autonome Vojvodina dhe krahina e dytë Kosova që janë lidhur me administratën e Serbisë. Që do të thotë është dashur të fillojmë nga zeroja edhe një herë pas Luftës së Dytë Botërore. Lufta, lufta mbaroi edhe një herë…

Ebru Süleyman: Ndoshta keni dëgjuar nga babai juaj për Luftën e Dytë Botërore, atëherë gjermanët, italianët e kan okupuar Kosovën dhe ndoshta pjesa më e madhe e komunitetit hebre vdes atëherë?

Mürteza Büşra: Po janë shkatërruar.

Ebru Süleyman: A e njihni ndoshta ndonjë familje hebreje apo armene? Nuk kam dëgjuar kurrë për ta.

Mürteza Büşra: Tani kur është ndonjë krizë ekonomike, edhe gjatë Jugosllavisë së vjetër gjithashtu, kur kishte krizë ekonomike, pse njerëzit imigronin? Njerëzit imigrojnë më së shumti për shkak të krizës ekonomike. Do të thotë kur njerëzit kanë mbetur pa tokë, gjatë periudhës së Mbretërisë, janë bërë reformat. Çfarë do të thonë reformat? Nëse ke pasur tokë më të madhe se dhjetë hektarë nuk mund ta punoje, është etatizuar. Atëherë shteti do t'ju jepte *renta* [mbështetje] pak ndihmë rreth njëzet e pesë përqind i shkonte pronarit. Por në dorën tjetër ti po jep 75 për qind të saj shumë lirë, shteti e përdor gjithë atë tokë dhe pjesë. Kjo është e mirë por çka ndodh me njerëzit që kanë mbetur pa tokë? Ata e ndjejnë nevojën për të imigruar dhe ata imigrojnë. Tani, kush imigron më shumë? Me siguri, njerëzit që nuk kanë tokë apo shtëpi, njerëzit që kanë mbetur pa shtëpi. Çfarë do të bëjnë ata?

Por, nuk ka qenë aq e lehtë edhe nëse ke dashur të imigrosh në atdhe. Dua të them, kemi parë disa nga shembujt e kësaj edhe sot. Për shembull, imigrimi nga Bullgaria, migrimi masiv me kafshë, bagëti, lopë, karroca, kështu kanë imigruar. Nuk kishte madje as trena për transport. Ka qenë kohë lufte, kohëra të vështira, migrimet kanë filluar gjatë trazirave.

Pas kësaj, çka tjetër, klima është një faktor tjetër që ndikon në migrimin e njerëzve por lufta e ka pasur efektin më të madh. Gjatë luftës, disa kombe humbën, u zhdukën. Për shembull, kur Jugosllavia u formua për herë të parë nga viti '18 deri '42 apo '45 disa kombe u zhdukën. Nuk kishin mbetur më qytetarë hebrenj, të ndjekur nga gjermanët ata u shpërndanë, ikën që këtu. Nuk ka bullgar, madje askush me prejardhje bullgare, nuk ka grek apo njerëz me prejardhje greke.

Por në disa kombe, u rrit numri i popullsisë, nivel i lartë i natalitet. Migrimi gjithmonë ekziston por edhe nataliteti. Tani kur vijmë tek ajo, kur i shikojmë të dhënat për lindje rreth vitit '45 dhe pas 1945, do të thotë pas Luftës së Dytë Botërore, e sheh natalitetin në komunitetet muslimane. Do të thotë te shqiptarët, turqit, boshnjakët, ata e kanë librin e popullsisë. Kjo është sepse, për shembull, nëse e krahasoni popullsinë në vitin '51 cilat janë nivelet e popullsisë shqiptare, popullsisë turke, popullsisë serbe, popullsisë boshnjake, popullsisë rome? Mund ta shihni se përqindja më e madhe është te populli shqiptar, për shkak të nivelit shumë të lartë të natalitetit. Kur e shikoni në një pikë ka qenë gjysma e popullsisë, sidoqoftë, më kujtohet edhe prej regjistrimit të popullsisë të bërë në vitin '70 ata e përbënin diku 75 përqind të popullsisë.

Ebru Süleyman: Po.

Mürteza Büşra: Dhe përveç atyre, kombi i dytë për nga madhësia kanë qenë serbët dhe të tretët kanë qenë turqit dhe të tjerët. Krejt mirë por pas tridhjetë vite për shembull, ku na dërgon rritja e popullsisë? Tani 90 për qind e popullsisë së Kosovës janë shqiptarë, apo jo? Eh pastaj, kush janë ata 10 për qind? Ndër muslimanët boshnjakë, turqit, romët dhe të tjerët. Malazezët… Ata e formojnë popullsinë sot. Është një diferencë e madhe në proporcion, për rritjen e popullsisë.

Ebru Süleyman: A të kujtohet kur e ke filluar shkollën, cili vit ka qenë?

Mürteza Büşra: Më kujtohet shumë mirë. Tani, unë kam lindur në 1946 por kur i kam pasur pesë vjet kam filluar të shkoj në shkollë. Pse? Për shkak të dajës, ai ka qenë njëri ndër mësuesit e parë. Në vitin 1951 shkolla fillore filloj punën. Vendimi u morr, regulloret, urdhri erdhi nga shteti që duke filluar nga 1951 shkollat në gjuhën turke do ta fillojnë punën. Dhe shumica e njerëzve i kanë pasur pesë, gjashtë, shtatë vjet, madje tetë, nëntë dhe dhjetë gjithashtu, të gjithë kemi qenë në të njejtën klasë. Më kujtohet që kemi hyrë në shkollë për herë të parë '51-tën.

Pasi që daja im ishte mësues ai më mori pak herët, kur kam qenë shumë i ri. Më kujtohet sikur të ishte sot, po e mësonim shkronjën "C" dhe mësuesi po e shpjegonte shkronjën "C" dhe disa nga shkronjat e alfabetit dhe unë thash "dajë, dajë" në vend se të them mësues kur kërkoja leje për ta shpjeguar shkronjën "C" dhe pjesa e leximit për të. Ai erdhi afër meje dhe më tha "Shiko", "Biri im Mürteza,

kujdes mos më thirr dajë më." "E si të thërras pra?" "Ose thuaj zoti mësues ose mësues", "Oh, në rregull është ashtu?" Unë i thash në rregull dhe nuk e thirra më dajë, e thirra mësues.

Ebru Süleyman: Si e ka pasur emrin daja juaj?

Mürteza Büşra: Njëri nga mësuesit e parë, zt. Ali, Ali Efendi. Kanë qenë në fakt dy [me të njejtin emër] njëri prej tyre u bë drejtor, Ali Ömer dhe tjetri Ali Efendi, kështu e thërrisnin dajën tim. Njëri prej mësuesve të parë. Për shembull, kemi qenë shumë ngusht në klasë të parë. Disi, kur na është dhënë një liri dhe pavarësi kur u lind mundësia e edukimit në gjuhën turke… Deri atëherë shumë familje që i dërgonin fëmijët e tyre në shkolla në gjuhën shqipe apo serbe e ndërruan në edukimin turk dhe e vazhduan shkollimin aty. Dhe në mesin e mësuesve të vjetër, përveç dajës tim, përveç themeluesve të parë këta dy mësuesit të dy të emërtuar Ali, kanë qenë gjithashtu Bedri Selim, Necmi Selim, vëlla Şükrü, Şükrü Zeynullah, mësuesi ynë. Perveç tyre mësuesit që nuk janë në jetë, ata punuan shumë për edukimin, për këto klasë të mbushura. Po ju them, në klasën time, kanë qenë pesëdhjetë, nuk kishte vend ishte shumë ngushtë.

Ebru Süleyman: A shkonit në shkollën Meto Bajraktari?

Mürteza Büşra: Ne mësonim këtu, në Elena Gjika, më herët e njohur si Vuk Karadžić, në këtë shkollë pikërisht këtu {me gjeste dore tregon drejtimin}. Dhe nuk na zinte dua të them nuk kishte mjaft vend, shumë nxënës vinin, ata donin të mësonin në gjuhën turke, ishte e tejmbushur. E dini shkollën fillore Emin Duraku në drejtim të tregut tani, kishte shkollim turk, në nivelin bazik të gjimnazit [Sami Frashëri], në bodrum, për shkak të mungesës së hapësirës dhe te pjesa që sot e thërrasim arkivi, ndërtesa e vjetër, kishte klasa për edukim turk atje gjithashtu, pra në pesë-gjashtë vende të ndryshme sepse kishim nevoj për hapësirë.

Shumica e popullit turk kanë qenë definitivisht pro marrjes së edukimit në gjuhën e tyre amë dhe kështu prindërit i regjistruan ata dhe ishin të mbipopulluara [klasat]. Krejt mirë por, në 1953-tën në atë turmë dhe nivel të lartë të nxënësve, kishte edhe shumë aktivitete jashtëshkollore. Ditët shkollore, festat zyrtare, festat shtetërore janë shënuar dhe janë përgaditur disa programe. Më kujtohen programet.

Pastaj më kujtohet në vitin 1953, motra ime ishte më e madhe se unë dhe kur ishte në klasa më të larta, në Prishtinë në shfaqjet që janë luajtur në shkollë, nxënësit që kanë performuar më së miri janë përzgjedhur për teatrin e qytetit. Teatri i qytetit, atëherë ka qenë korzoja e vjetër, pjesa e korzos, e dini që e përmendëm tregun e mbyllur, tani është aty ku është Kuvendi, pikërisht përball tij ka qenë një rrugë, e di korzoja ka qenë pikërisht aty ku rinia do të shëtiste, argëtonte veten. Posterat e kinemas, pikturat, gazetat në muri ishin aty gjithashtu. Kështu…
Çfarë tjetër do të dëshironit të dëgjonit, çka tjetër mund të ju tregoj?

Ebru Süleyman: Çfarë do që doni, a kishte kinema në atë rrugë…?

Mürteza Büşra: Ah si erdhi teatri, ke të drejtë. Nxënësit më të suksesshëm, më të suksesshmit në drama mund të bëheshin antarë të teatrit. Në fakt, [teatri] ka prodhuar, kanë ringjallur aq shumë drama të mira sa që i gjithë qyteti ishte kureshtar për atë se çka po ndodhte në teatër duke thënë "ua këta fëmijë më të vërtetë po sjellin punë të mrekullueshme në skenë".

Më të vërtetë kishte një interesim të madh në 1953, fëmijët ishin aktiv atje me aktivitet jashtëshkollor. Më kujtohet sikur të ishte dje, Maçoku me qizme, Detyrat e shtëpisë shfaqjet e dramës dhe artisti i teatrit me emër Mazhar Kadriu vinte si drejtor dhe falë tij drama bëhej shumë e suksesshme. E gjithë Prishtina ishte kureshtare, edhe të rriturit vinin aty, baballarët tonë, nënat tona, vinin të shihnin se çfarë po bënin fëmijët, artistë të mëdhenj.

Ebru Süleyman: Pra motra jote kishte rol?

Mürteza Büşra: Edhe motra ime kishte role dhe unë isha kureshtar prandaj shkoja t'i shikoja provat dhe nuk e humbisja asnjë shfaqje. Imagjinoja kur isha fëmijë që do të bëhesha artist kur të rritesha. Por teatri ka marrë shumë vëmendje në qytet. Për shembull, shfaqjet e dramës janë bërë gjithashtu në gjuhën serbe dhe shqipe por më të suksesshmet kanë qenë ato që i kanë bërë nxënësit. Por pas kësaj, e dini katastrofën e migrimit që i ka ndodhur shoqërisë.

Ebru Süleyman: Ka qenë në vitet e 50-ta apo jo?

Mürteza Büşra: Nga e 53-ta deri 56-tën teatri vazhdoi në mënyrë shumë të suksesshme, si shtesë ka pasur një numër të konsiderueshëm të nënësve në të gjitha shkollat. Aq sa nëse i kishim pasur ato numra sot nuk do të kishim vende prapë, nuk do të na mbante kjo shkollë {Elena Gjika}. Por çfarë ndodh pastaj, në njërën anë turqit, shqiptarët fitojnë të drejta, kanë disa të drejta por në anën tjetër, shteti i jep vend edhe migrimit. Kur kjo rrugë u hap, familjet ngadalë filluan të migrojnë për në Turqi dhe kështu filloi, ngadalë 53-tën dhe 54-tën dhe u përshpejtua shumë 55-tën dhe 56-tën.

Ebru Süleyman: Pse po thoni që ka pasur aq shumë migrime këto vite?

Mürteza Büşra: Mirë, siç folëm edhe më herët për arsyet e migrimit, çka mund të jetë, mund të jetë kriza ekonomike. Kur dikush mbetet pa tokë, pa kopsht, ferm, kalon në varfëri dhe shikon një mundësi mbijetese dhe atë çfarë zgjedhin është migrimi, është fati i tyre atëherë. Dhe çka tjetër mund të shkaktoj migrim, presioni? Për shembull, minoritetet kanë qenë të shtypura sa që ka ardhur deri tek migrimi. Ka shumë migrim nga Kosova.

Ebru Süleyman: Popullsia zvogëlohet.

Mürteza Büşra: Sigurisht, po popullsia zvogëlohet përgjysmë sikur që ndodhte pas luftërave. Le të themi nëse kanë qenë 16 mijë njerëz, kur ndodhte lufta gjysma e popullsisë shkonte, i lëshonte këto vende dhe qyteti boshatiset përgjysmë. E njejta është me migrimet, e shikon dhe e sheh, fqinjtë po migrojnë, të afërmit po migrojnë, edhe nga frika gjithashtu. Ne e mbijetuam këtë njëzet vite më parë.

Ne u frikësuam nga presioni. E dini thonë, "*Korki daglari bekler"* [Frika ruan malet]. Si rezultat, njerëzit migrojnë nga frika. Pra situata ka vazhduar në vitet 1956, '57, '58 deri 1960. U zvogëlua në vitet 1960 por sigurisht, migrimi ka vazhduar deri në vitin 1960. Kështu klasat tona në shkollë u boshatisën. Gjysma e popullsisë apo më shumë, sepse kur i shikojmë fotot e vitit 1951, '55 aty janë 40 apo 50 njerëz në foto. Ku janë ata sot? I sheh që nuk i ke shokët e klasës përreth, atëherë e kupton.

Kur e bëja punën si gazetar, shpesh e vizitoja Prizrenin dhe Mamushën dhe aranzhoja transmetimet e nxënësve në shkolla. Kur po aranzhoja, në shkollën e Mamushës Hacı Lütfi Ömer, drejtori dhe mësuesi gjithmonë thoshte se janë gjashtëqind nxënës. Unë po thosha si është kjo e mundur sa herë që vij janë gjashtëqind nxënës. Ata e pyetën Nasredin Hoxhën[5] "sa vjet i ke?", ai gjithmonë është përgjigjur që i ka katërdhjetë vjet. "Nasredin Hoxha pse gjithmonë po thua që i ke katërdhjetë vjet?", sikur këta në shkollë gjithmonë gjashtëqind (qesh). Por me papërvojën time, nuk e kuptoja që migrimi dhe nataliteti po e balanconin njëra tjetrën. Sa ka migrim ashtu ka edhe natalitet. Është një rastësi. Del se kjo ishte ajo që nuk kuptoja.

Jeta është e tillë, migrimet kurrë nuk ndalojnë. Para njëzet viteve e kemi tejkaluar këtë, kur ka presion duhet të kërkosh zgjidhje, duhet të migrosh. Gjysma e njerëzve kanë migruar, sigurisht, shumica e tyre te fqinjët si në Shqipëri, disa prej tyre në Turqi dhe në shtete evropiane, kombi ynë u shpërbë. U deshën vetëm disa ditë që gjysma e popullsisë të migroj. Çfarë do të thotë frika? Kjo është.

Ebru Süleyman: Ju thatë që shkonit në korzo kur ishit i ri?

Mürteza Büşra: Oh, si edukoheshim në shkolla. Ne edukoheshim në shkolla fillore {tregon shkollën} përball meje. Edukimi në gjuhën turke. Paraprakisht, ne nuk kishim shkollë të mesme. Përgaditjet për shkollë të mesme filluan vetëm 1962-tën. Në 1963 u bë valide. Në vitet akademike 1962 - 1963 u hap gjimnazi. Nxënësit turk i mbushën klasat në shkolla të mesme. Unë u regjistrova në gjimnaz 1963-tën si grada e tretë e klasës sime. Pasi e përfundova shkollën fillore vazhdova me shkollë të mesme.

Derisa prindërit e mi ngjanjëherë thoshin "Bir, më mirë puno me zanat nuk ka nevoj për edukim të mëtutjeshëm". Për ata, i biri i zanatçiut duhet gjithashtu të bëhet zanatçi. Kështu preferonin ata. Por atë vit unë po mendoja të transmetoja në radio. Si fëmijë pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë vjet, njëri nga profesionet më të reja doja të transmetoja në radio. Atëherë nuk kishte televizion, vetëm radio. Shumë dëshiroja të bëhesha riparues i radiove apo të transmetoja në radio. Por atë vit nuk kishte regjistrim për profesionin, nuk ka ndodhur, nuk pata fat.

Dhe që të mos ndahesha nga shokët e klasës, vazhdova në shkollë të mesme. Sic e dini pas katër vitesh edukim me emocione pyesnim nëse do ta vazhdojmë fakultetin apo jo apo rruga më e mirë do të ishte ta kesh një punë çfarëdo, po e diskutonim me prindërit tonë. Mirë, atë vit po thosha që u hap Shkolla Pedagogjike në gjuhën turke në Prishtinë në vitin 1962. Në fakt, së pari u hap në Prizren dhe pasi diplomoi gjenerata e parë ata kaluan në Prishtinë. Ne e formuam gjeneratën e parë në Prishtinë,

[5] *Nasredin Hoxha* ka qenë *Seljuq* satirist i shekullit të 13 i cili ka jetuar në Turqinë e sotme. Ai është konsideruar filozof popullist dhe një Sufi që mbahet mend për tregimet e tij qesharake dhe anekdotat.

rreth trembëdhjetë-pesëmbëdhjetë studentë kanë qenë të rregullt dhe afërsisht një numër i njejtë kanë qenë të parregullt.

I ndjeri Süreyya Yusuf, Bayan Sabahat, Mahmut ka qenë aty, nga Prizreni, Süleyman Brina të gjithë kanë vdekur. Pas gjithë kësaj, ka pasur ndryshime të mëdha në Shkollën Pedagogjike. Edukimi ka qenë dy vite dhe ne kemi dashur që ai të jetë katër vite i gjatë por nuk i'a kemi arritur sepse autoritetet kanë sugjeruar që ne ta hapim Degën e Orientalistikës. Në Degën e Orientalistikës ligjeratat janë kryesisht në gjuhën arabe, është gjuha dhe letërsia arabe, gjuha dhe letërsia persiane, e gjithë kjo është në rregull por disa nga mësuesit në Shkollën Pedagogjike kanë deklaruar se do të ishte më mirë nëse do ta hapnin Degën e Turkologjisë. Edhe pse prapë nuk patëm sukses. Atë vit Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nuk mund të hapej por Dega e Orientalistikës u hap.

Në atë kohë orientalistët e famshëm jugosllav duke përfshirë edhe Hasan Kaleshin po jepnin ligjërata si profesorë në Degën e Orientalistikës. Ka zgjatur për rreth dhjetë vite. Më vonë në vitin 1988 pas kërkesave tona, Dega e Turkologjisë është themeluar në Fakultetin e Filologjisë. Gjatë themelimit, u rrit numri i studentëve, mjaft studentë u bënë personel deri tani Dega e Turkologjisë është ende në vazhdim (qesh). Kështu është më mirë, të edukohesh në gjuhën amtare është gëzim dhe nder.

Ebru Süleyman: Ju keni diplomuar në Shkollën Pedagogjike pas kësaj çfarë ndodhi?

Mürteza Büşra: Menjëherë kam filluar punën si mësues në Shkollën fillore Meto Bajraktari. Në atë kohë ka pasur edukim turk në atë shkollë. Në kohën time në vitet 70' kishte pozita të lira për personel në shkolla sepse mësuesit ishin në pension dhe unë e kam zëvendësuar pozitën dhe kam filluar të punoj. E doja punën time (qesh) në fillim, kush nuk do ta donte, ne e përqafuam profesionin tonë dhe u munduam t'i imitonim profesorët më të mirë sepse filluam të punojmë me dashuri dhe simpati dhe kur silleshim kështu ne krijonim gjeneratë të shkëlqyer dhe në atë periudhë kishte shumë nxënës në shkolla (qesh).

Ebru Süleyman: Për cilat vite po flasim?

Mürteza Büşra: Për herë të parë kur kam filluar të punoj si mësues ishte në mars të vitit 1970. Pasi kam punuar pesë-gjashtë vite punoja me gjithë zemër gjatë ditëve të rëndësishme në shkollë, po e bëja një punë të mirë me prezantimin e programeve. Disa prej shokëve të mi e kanë pëlqyer dhe falë tyre [e mora një ftesë që thoshte] "Eja këtu sepse Radio Prishtina nuk ka gazetarë, nuk ka transmetime për fëmijë, neve na nevojitet personeli, a do të vije?". Më morën atje dhe më thanë, "Definitivisht duhet ta bësh transmetimin për fëmijët".

Disa prej shokëve të mi edhe sot thonë që unë kam qenë mësues i mirë, ata thanë, "Do të ishe mësues i shkëlqyer po ta vazhdoje atë karrierë". Me të vërtetë ka qenë profesion që e doja. Të punoj në arsim ka qenë me të vërtetë e shenjtë, ka qenë një nder në vete dhe e doja por e dini, fatkeqësisht, fati… Kur u zhvendosa në radio fillova me transmetimin për fëmijët. Në atë kohë, kishim një kasetë që e thirrnim *nagır*, një mjet i stërmadh i bërë me teknologjinë e asaj kohë. Do e merrja atë kasetë, e mbaja atë si portier deri në Prizren pasi që programet realizoheshin vetëm përmes vizitës së shkollave fillore.

Për më tepër, më kujtohet kur i bënim transmetimet për fëmijë atëherë, punonim me katër tema qendrore. Njëra prej atyre temave primare është thirr *Okuldan Sesler* [Zërat nga Shkolla] dhe kjo kërkonte patjetër të udhëtoje, tek të gjitha vendet që kishin edukim në gjuhën turke, ne i vizitonim të gjitha ato shkollat.

Ebru Süleyman: Kjo ka qenë rreth vitit '74?

Mürteza Büşra: Po rreth vitit '74 apo '75, në fakt në vitin '74 ndërtesa e re, Radio Prishtina e sotme është hapur me siguri. Njëra ka qenë në Slloveni, Lubljanë si kjo, shumë mirë e dizajnuar, ndërtesë moderne dhe njëra nga këto po ndërtohet në Prishtinë. Për shkak të mungesës së hapësirës radio dhe televizioni nuk mund ta ndanin më të njejtën hapësirë dhe ato janë ndarë [në ndërtesa të ndryshme] dhe radio e ka ndërtesën e saj. Radio kishte shumë punëtorë, më shumë se [televizioni] dhe gjithashtu kishte një traditë të gjatë, ishte themeluar para shumë kohësh {gjestikulon prapa me dorë}. Radio filloi [punën] pas vitit 1944 apo '45 kurse programet televizive erdhën pas viteve të '80-ta, pra [radio] është një profesion i vjetër. Dhe prandaj…

Edhe për këtë je krenar, unë e përqafova transmetimin për fëmijët, ju tregova se njëri nga programet kryesore quhej *Okuldan Sesler* [Zërat nga shkolla] dhe unë shkoja në Prizren shumë shpesh. Kishim vetëm dy shkolla fillore atëherë kurse në Prizren ishin gjashtë të tilla! Që do të thotë kishim shumë punë, mund t'i mbushje kasetat me orë të tëra, kishte shumë nxënës, në numër...

Ebru Süleyman: A kan qenë atëherë Prishtina dhe Prizreni edhe më të ndryshme? Kur udhëtoje nëpër qytete në Kosovë..

Mürteza Büşra: Jo por…

Ebru Süleyman: A keni hasur ndoshta në gjëra interesante, gjatë vizitave tuaja?

Mürteza Büşra: Kur thua ndryshime, për çka po mendon, sigurisht ka disa lloje të ndryshimeve. Ne shkonim në Prizren dhe kjo na e lehtësonte punën, i mbushje kasetat më shpejtë ishin gjashtë shkolla fillore, vetëm shkolla fillore, gjashtë prej tyre! Kurse ne kishim vetëm dy shkolla fillore. Mamusha ishte gjithashtu afër Prizrenit, ne shkonim dhe inçizonim edhe atje. Kishte shfaqje në shkollë, ne i vizitonim kur kishin shfaqje apo kur ishte ndonjë datë e rëndësishme, ndonjë festival apo diçka e tillë. Dhe ne i inçizonim performancat e fëmijëve, duke ju zgjatur mikrofonin dhe duke inçizuar në mënyrë autentike, çfarë do që kishin për të thënë. Apo i inçizonim performancat e dramës, këngët, këngët e koreve, i mblidhnim këto dhe i transmetonim nga studioja shumë lehtë.

Dua të them, e doja punën aty, e përqafova shumë. E kam kaluar jetën në botën e fëmijëve, me fëmijët, duke vizituar shkollat… Përveç kësaj, kam pasur transmetim që i përfshinte edhe të rriturit, në *Okuldan Sesler* [Zërat nga shkolla] kishim biseda edhe me mësuesit. Ato transmetimet gjithashtu kishin subjekte interesante. Intervistat që i bëja me të rritur i jepja programit të lajmeve apo këtij programi tjetër që i'a përmenda emrin.

Ebru Süleyman: Ti po i përgatisje intervistat?

Mürteza Büşra: Epo tani, kur shkoje në studio duhej të bëheshe teknik vet. Ne si gazetarë kur i merrnim kasetat me vete nuk ka qenë e lehtë t'i inçizoje vetëm ashtu. Si ju tani me kameramanin, [intervistat] kanë qenë të mundura vetëm me dy apo tre njerëz atëherë e merrnim stafin teknik me neve.
Fillimisht na nevojitet edhe një vozitës i veturës, apo jo? Na nevojitet tekniku i zërit, bashkë me gazetarin janë gjithsej tre, katër persona. Shkonim te shkolla për t'i shikuar aktivitetet aty. Pra, kështu është realizuar. Atëherë, kasetat kanë qenë ekstremisht të rënda {gjestikulon rëndë me duar}, gjëra të stërmëdha të rënda, me kohë e kupton që ato janë zvogëluar, në stilin miniaturë që japonezët e kanë zbuluar, më kompakte.

Ebru Süleyman: Për tu mbajtur më lehtë.

Mürteza Büşra: Për tu mbajtur më lehtë. Në të njëjtën mënyrë në ditët e sotme, ka rekorder të tillë si kjo {tregon pëllëmbën} që e bëri profesionin tonë shumë më të lehtë, tani nuk kemi nevojë për të gjithë teknikët e bëjmë vetë.

Ebru Süleyman: Pyetjet dhe koncepti i programeve të transmetimit janë bërë nga ju?

Mürteza Büşra: Sigurisht, puna në transmetimet radiofonike të fëmijëve është shumë e ngjashme me atë të një mësuesi dhe unë kisha qëndruar në atë përvojë timen dhe kështu inçizonim me lehtësi transmetimet e fëmijëve. Për shembull, ne i inçizonim të gjitha aktivitetet e fëmijëve. Apo vet, përgatisja disa radio drama vet, ka pasur shumë shfaqje që i janë dedikuar botës së fëmijëve. E zgjidhje njërën nga ato dhe e bëje çdo hap të produksionit vet, preludin, epilogun, regjinë dhe duhej t'i kalkuloje gjithashtu të gjitha detajet teknike, i gjithë korpusi kompletohej nga drejtori i transmetimit, ne e bënim këtë si gazetarë, gjithë këtë.

Nuk kishim shumë nevojë për drejtorin e produksionit. Vetëm për programet e vitit të ri apo nëse merrnim pjesë në gara apo konkurse. Ne merrnim pjesë në gara të ndryshme. Garat bëheshin në Ohër, njëherë e kemi fituar vendin e tretë dhe një herë tjetër transmetimi i fëmijëve e ka fituar vendin e parë. E sheh, kështu, [i'a kemi arritur] duke u bazuar në përvojën tonë, kemi marrë shumë ndihmë.

Ebru Süleyman: Po është shumë e veçantë të flasësh me fëmijët dhe të inçizosh çfarë kanë ata për të thënë, të krijosh diçka.

Mürteza Büşra: Tani shiko është një artist i quajtur Halit Kıvanç në Turqi. Ai ka drejtuar një numër të festivaleve të fëmijëve dhe i ka udhëhequr ato. E dini ai ka qenë prezantuesi, ka drejtuar aktivitete të ndryshme që kanë ndodhur nëpër gjithë Turqinë. Dhe në Kosovë, ne, unë kam qenë dhe shokët e mi gjithashtu kanë punuar me fëmijë por para meje, ka qenë Enver Baki, për shembull, që e ka krijuar transmetimin e parë për fëmijë nga gjenerata jonë.

Sidoqoftë, pas Enver Baki, ka qenë Cevahir Halaç i cili ka vdekur. Ai punonte në transmetimin e fëmijëve dhe po e krijonte një punë shumë të mirë. Ai ma dorëzoi mua. Pas kësaj, shefi ynë Muhamet Ustaibo gjithashtu ka qenë i involvuar në transmetimin për fëmijë. Në gjeneratat para neve, atëherë, për shembull, radio u themelua në vitin 1951 për herë të parë dhe filloi transmetimin por ka qenë vetëm gojor. Nuk ka qenë si sot, jo me këto kushte, është dashur të bëjnë transmetime të drejtëpërdrejta. Nëse diçka është dashur të transmetohet, disa lajme të lexohen, atë e bënin drejtëpërdrejt. Nëse kori do ta këndonte një këngë, ata shkonin brenda studios {bën me gjest ngushtimin} dhe i këndonin këngët e tyre që do të transmetoheshin drejtpërdrejtë. Për shembull, së bashku me orkestër. Në fakt, është dashur ta sillje orkestrin e madh në studio sepse vetëm drejtëpërdrejt mund ta transmetoje, teknologjia ka qenë e tillë, një teknologji shumë e thjeshtë.

Pra transmetimi ka qenë fillimisht i drejtëpërdrejt por në disa raste konstruksioni i studios ka qenë shumë i përshtatshëm. Pse? Sepse atëherë transmetimi mund të bëhej me prezantues, në një mënyrë të mirë përgaditur. Dhe kështu transmetimi ynë ishte shumë i mirë. Që do të thotë se nëse përgatitesh mirë për një bisedë me dikë, është më e favorshme, apo jo? Ne mund t'i aktualizonim transmetimet tona në studio. Dhe pas kësaj, mund ta dërgonit direkt në arkiv. Dhe Radio Prishtina u bë aq e fuqishme, antenat e marrësit dhe transmetuesit ishin një kilovat. Një kilovat [e ka bërë të mundshme transmetimin] që të dëgjohet në pothuajse të gjitha shtetet e Ballkanit, lajmet nga Kosova dhe transmetimet e kryera në radio…

Ja pse po them që studiot na e lehtësonin punën. Kasetat, në vend se t'i bartnim të gjitha ato kasetat e mëdha, tani ne i kemi më të vogla {gjestikulon me duar}.

Ebru Süleyman: Sa vite keni punuar për radion?

Mürteza Büşra: Unë kam punuar në radio për saktësisht njëzet e pesë vite (qesh). Po siç e dini, pas luftës së fundit disa mundësi nuk ekzistojnë më dhe për atë arsye, nuk ka qenë e mundshme [të vazhdoj]. Ne, gazetarët me më shumë përvojë, gazetarët e vjetër, është dashur që ne ngadalë ta lëshojmë punën tonë dhe t'ua lëmë më të rinjëve, gazetarëve të rinj që u shfaqën dhe erdhën. Pra ata vazhduan pas luftës.

Në këtë rast, sa kemi qenë ne, mendoj tridhjetë njerëz në personelin editorial dhe mendoj që vetëm pesë apo gjashtë prej tyre punojnë sot atje, ndoshta po ta pranonin stafin një apo dy më shumë mund të shtoheshin, shumë pak. Në krahasim me atëherë, kemi pasur shumë transmetime, njëzet e dy transmetime të ndryshme nëse e konsiderojmë kohën që na marrin, [zgjatja e programit] ka mbërritur, pesë, gjashtë, shtatë orë. Mendoj që është e rëndësishme që ne patëm mundësi të transmetojmë për kohë aq të gjatë në gjuhën turke.

Ebru Süleyman: Po, të keni aq shumë kohë të ndarë.

Mürteza Büşra: Po, pikërisht ashtu. Gjithashtu, ka pasur një të kaluar të gjatë, nëse e mendon se ka filluar në vitin 1951, sa vite kanë kaluar? Përvjetori ynë jubilar po afrohet janë bërë rreth shtatëdhjetë vite. Viti 1951 është vit shumë i rëndësishëm për komunitetin turk. Do të thotë, ne patëm mundësi ta

kemi edukimin në gjuhën turke në gjuhën tonë amë dhe përveç kësaj, Radio Prishtina fillon transmetimin. Për më tepër shoqatat janë formuar. Për shembull, për herë të parë në Prishtinë, një shoqëri e mrekullueshme e quajtur *Yeni Hayat* [Jeta e re] e formuar nga komuniteti turk vjen në ekzistencë. Gjithashtu, *Doğru Yol* [Rruga e drejtë] shoqata në Prizren. Këto janë shoqatat më të vjetra. Që do të thotë, ato janë shoqatat e formuara në vitin 1951.

Ebru Süleyman: Dhe radio gjithashtu fillon transmetimin në vitin '51?

Mürteza Büşra: Po, në fillim siç ju tregova ishin të drejtëpërdrejta sepse nuk kishte studio.

Ebru Süleyman: Po gazetat dhe revistat?

Mürteza Büşra: Ah po, po më vonë gazeta *Tan* kjo ka qenë '69-tën gati të '70-tën. Gazeta *Tan* ka qenë shumë e pasur me përmbajtje, ka qenë gazetë javore por ka qenë mjaft e pasur. Për shembull, mësuesit shpesh shkonin aty për të bashkëpunuar, ata bashkëpunonin me gazetarë. Ata i bashkoheshin gazetës *Tan* si korrespondent. Ka qenë mjaft e pasur dhe ka pasur përmbajtje intriguese dhe ishte mjaft e dashur. Kjo ishte gjithashtu e shpërndarë në Ballkan mes komuniteteve turke që jetonin aty. Gazetat tona arrinin edhe në vende shumë të largëta.

Ka qenë edhe revista për fëmijë *Kuş* përbrenda gazetës, ne kishim revistë. Do të thotë përveç të rriturve, u sigurua edhe bota e fëmijëve. Ka qenë një faqe brenda në gazetë që ju dedikohej fëmijëve por kjo ka qenë nga revista e fëmijëve me të njejtin emër *Kuş.* Me nderin që na solli *Kuş,* ne merrnim pjesë në ceremoni nëpër gjithë Jugosllavinë. Organizohej në Novi Sad në atë kohë, quhej *zmajevi deče*, festivali i fëmijëve Jovan Jovanoviq Zmaj. Nga të gjithë njerëzit e Jugosllavisë nga të gjithë përfaqësuesit, një apo dy fëmijë nga të gjitha republikat merrnin pjesë në gara së bashku me mësuesit e tyre. Me poema, proza ne shkonim atje dhe rrinim së bashku në atë ceremoninë e organizuar në Novi Sad. Ka qenë një jubile i madh, i organizuar çdo vit.

Më kujtohet një vit, në krye të ekzekutivit, në krye të administratës së revistës *Kuş*, poeti ynë i madh dhe i famshëm Necati Zekeriya, e dini? Ai erdhi. Ka qenë një nder i madh! Poet dhe shkrimtar i mirënjohur në gjithë Jugosllavinë, po e përgatiste revistën *Kuş* këtu në Prishtinë! Kjo ishte një punë e madhe. Pastaj në këto ceremoni që organizoheshin çdo vit në Novi Sad, më kujtohet një vit ju nevojitej dikush të fliste për temën e letërsisë turke. Në këtë ceremoni, ka qenë anë e mbanë Jugosllavisë në shkallë të lartë. Pastaj vëllau ynë i ndjerë Necati e ka paraqitur letërsinë turke në atë mënyrë sa që shkrimtarët dhe poetët më të vlefshëm të Jugosllavisë kanë qenë të mahnitur, ata thoshin, "Shiko Necati Zekeriya na ka njoftuar me letërsinë turke".

Gjithashtu kishte edhe shumë interesim. E dini, letërsia turke e ka një të kaluar të gjatë dhe ne kemi letërsi mjaft të vlefshme. Dhe kështu Necati fliste për vlerën e revistës *Kuş*, si është realizuar, kush kanë qenë përkrahësit dhe flisnin për njerëzit turk e jugosllav të shkronjave si dhe për shkrimtarët turk të njohur ndërkombëtarisht. Për libra, edukimin, botën e fëmijëve në Turqi, e ka shpjeguar aq mirë ka kompozuar një bisedë aq të mirë sa që të gjithë ishin kureshtar për atë.

Dhe… Mund të shihje nga pamja e tij që ai është poet, nga sjelljet e tij. Ai e donte shoqërinë, e ka dashur shumë dhe ka pasur shoqëri në çdo vend! Në një moment, shikon dhe revistat e fëmijëve arrijnë nga Sllovenia, nga shokët e tij, arrinin nga Vojvodina, Kroacia, Bosnja, Maqedonia… Ai pranonte dhe i mirëpriste shokët dhe revistat [të dërguara nga shokët] prej çdo vendi. Prandaj ai edhe lulëzoi në krijimin e të vlefshmes gazetë *Kuş*. Ai ishte shumë i mençur, njeri shumë inteligjent.

Dhe ai pati sukses në botën e fëmijëve me tregimet e tij. Tregimet e tij janë përkthyer në të gjitha gjuhët, në të gjitha gjuhët e Ballkanit. Ai kishte disa tregime të lexuara shumë dhe fëmijëve ju pëlqente shumë. Dhe si rrjedhoj, jeta jonë si gazetarë ka kaluar kështu. Dhe pas luftës, në një mënyrë ne jemi pensionuar e kemi lënë profesionin tonë, jemi plakur. Është lënë për njerëzit e rinj. Çfarë thonë ata? Fëmijët janë intelektual të së nesërmes. Dhe pra, kështu...

Ebru Süleyman: Harrova t'ju pyes, ju thatë që nëna juaj është gjithashtu nga Prishtina, nga e cila familje? I përmendët pak xhaxhallarët tuaj, shtëpinë e tyre.

Mürteza Büşra: Familja Siçan, janë disa mbiemra si ky Siçan, Çeçis në Prishtinë. Pra linja e familjes Siçan. Dhe si e morën këta këtë mbiemër? Të shohim, kur Prishtina ka qenë shumë e vogël, të themi para njëqind vitesh, gjyshi ynë vinte nga Tauk Bahçja shiu e kishte lagur, dhe njerëzit thanë "oh shiko Ali Efendi qenka lagur qull" e dini si thuhet, "Jam lagur si miu" pra nga ajo idioma, familja e ka marrë mbiemrin Siçan. I kemi disa emra të çuditshëm të tillë, Çeçi, Kocadiş. Kështu, pra pasi që qyteza ka qenë e vogël, edhe një ngjarje shumë e vogël mund të sjellte një nofkë. Kështu.

Shtëpia e nënës time ka qenë në qendër sot. Më kujtohet kur rrugët ndërtoheshin me kalldërm në Prishtinë, e dini tani si janë rrugët e shtruara me asfallt? Atëherë ishin me kalldërm. Ishte fantastike, trotuaret e vjetra largoheshin dhe kjo ishte mënyra më e pastër më e bukur e shtrimit të rrugëve për transport. Dhe kishte gara me motoçikleta (qesh). Shtëpia e vjetër e nënës sime me dy kate, e shoh madje atë shtëpi në fotografitë e Prishtinës së vjetër, gjithashtu do t'ua jap juve nëse e gjej.

Ebru Süleyman: Pra ka fotografi të saj?

Mürteza Büşra: Po, një pamje e mirë.

Në katin e dytë, e gjithë familja jonë mblidhej aty, fëmijët e xhaxhait tim. Xhaxhai im kishte gjashtë fëmijë, ishin gjashtë vëllezër e motra, ne tre edhe djemtë e hallës sime gjithashtu vinin dhe ishim diku pesëmbëdhjetë fëmijë. Ne dëshironim të shkonim në atë shtëpi, shtëpi e madhe. Në katin e dytë, shikonim garën. Çdo aktivitet që bëhej në Prishtinë, e shihnim shumë lehtësisht prej aty. Dhe aty ishin garat me motoçikleta.

Ebru Süleyman: Pra ajo tashmë ka qenë qendër?

Mürteza Büşra: Po, definitivisht. Të gjitha garat bëheshin aty. Pikërisht aty bëheshin garat me motokros {lëviz dorën në rreth}.

Ebru Süleyman: Çfarë mendoni me motokros? Këto ishin motoçikleta?

Mürteza Büşra: Po po, motoçikleta. Nuk kishte as vetura atëherë. Po flas për vitet '52 apo '53 deri '55. Në vitin '55 çka ndodhi me këtë rrugë? Duke u bazuar në plan, çdo gjë që ishte e vjetër duhej të rrënohej dhe të ndërtohet në vend të saj diçka e re. Epo ok, shumë mirë por e kanë rrënuar tashmë tregun e mbuluar. Shiko Sarajevën tani e kanë tregun e vjetër, e kanë ruajtur. Është pazari i vjetër në Shkup, e kanë ruajtur. Pse nuk u ruajt këtu? Kjo është ajo që duhet të mëshirohet në fakt.

Ebru Süleyman: Pra atëherë, i ke parë të gjitha rrënimet e kësaj kohe, si je ndjerë për këto, për ndryshimin e qytetit?

Mürteza Büşra: Po sigurisht. Pasi shkoja te babai im në tregun e mbyllur, pushimet që i kam kaluar aty, më mungon, e kërkoj dhe e dëshiroja. Sikur ta kishim ende tregun tonë të vjetër, pse jo. E shihni, vetëm Zoti e di se a janë bërë në mënyrë korrekte disa vendime. Ç'rrënjosin menjëherë ambientin e mjeshtërve, prodhimin e tyre, artin e tyre {bën me gjest dyshimin}, sa korrekte mund të jetë? Sa e dobishme mund të jetë? Nuk mund ta shpëtonim, Prishtina nuk ka mundur të shpëtoj. Do të ishte më mirë nëse njerëzit e autorizuar do të mendonin për të. Do të kishim panaire në rrugë. Më kujtohet, njerëzit shkonin edhe në Gjilan në panairet e rrugëve por i kishim edhe këtu.

Për shembull të marteve, në pjesën që ne e quanim tregu i mbyllur, kanë qenë më shumë se pesëqind dyqane, blerjet bëheshin më së shumti të marteve. Për shembull saraçët, prodhimet e tyre, frerët, shalët, dhe rrethet janë shitur për kafshët sepse fshatarët, njerëzit që punonin me kafshë vinin në Prishtinë dhe i blenin. Kishte shitje të mëdha të marteve. Ne si shegërt as nuk mund të largoheshim nga pronarët tonë as për një minut duke filluar herët në pesë të mëngjesit deri në mbrëmje. Pse? Sepse i fitonim pesë dinarë, paratë tona javore të xhepit pasi i ndihmonim pronarët tonë. Kështu ka qenë, e donim punën si shegërt që në moshë të re.

Ebru Süleyman: Ju keni qenë tre fëmijë, motra juaj e madhe, ju, dhe?

Mürteza Büşra: Po, dhe vëllau im. Babai ynë u pensionua në moshë shumë të re. Çuditërisht me të vërtetë, në epokën e vjetër të Jugosllavisë ose në epokën e re Jugosllave gjatë Titos, sepse ishte sistemi socialist, ajo që ishte e rëndësishme ishte përvoja juaj e viteve. Babai im kishte punuar që kur ishte një djalë i vogël dhe pasi ju mblidheshin tridhjetë e pesë vjet përvojë mund të dilnit në pension. Ai kishte pesëdhjetë e pesë vjet, i ri. Sot ne dalim në pension me gjashtëdhjetë e pesë. Atëherë mund të dilje në pension dhjetë vite më herët. Pse? Sepse kujdeseshin për punën. E dini, sistemi socialist kishte rregulla që nëse i ke bërë tridhjetë e pesë vite përvoj pune mund të dilje në pension.

Ebru Süleyman: Dhe nëna juaj ishte amvise?

Mürteza Büşra: Nëna jonë ishte amvise, siç ka qenë traditë atëherë. Atëherë femrat shkonin në medrese për disa vite dhe mësonin të shkruanin, mësonin të lexonin në gjuhën arabe. Dhe ajo mund të lexonte, për shembull, me lehtësi lexonte *Yasin*, do të thotë që ka mësuar mirë në medrese. Ajo ishte e aftë të lexonte vargjet dhe pjesët e Kur'anit. Pra atëherë, nëna ime u lind në vitin 1915, kështu

që ata ishin fëmijët e viteve '25. Çfarë mund të ishte atëherë? Kishte vetëm medrese dhe nuk kishte mundësi të tjera të edukimit në gjuhën turke, jo në shqip, vetëm në gjuhën serbe. Do të thotë pas vitit '18 deri 1940. Edukimi ka qenë i tillë atëherë?

Ebru Süleyman: Kur jeni martuar?

Mürteza Büşra: Mirë, tash. E shihni, njeriu i ka tridhjetë e dy dhëmbë apo jo, profesionistët mjekësorë thonë kështu. Dhe ne bënim shaka për këtë dhe thoshim, "Shiko, nënë, sapo t'i bëj 32 do të martohem", "Ashtu a?", "Po pikërisht". Dhe me të vërtetë u martova kur i kisha tridhjetë e dy vjet. Tani i kam 72 vjet dhe janë bërë katërdhjetë vite. I kemi dy fëmijë, një vajzë, dhe një djalë. Vajza ime punon në Eurokoha ajo ka diplomuar në Turizëm dhe Hotelieri, ka studiuar në Bursa. Djali im ka qenë këtu, ai nuk e ka pasur shansin të shkoj në universitet. Punon këtu dhe e fiton bukën e gojës. Ne jetojmë bashkë me djalin tim dhe nipat dhe jemi të lumtur, ne ndjehemi të kënaqur, çfarë jetë e bukur (qesh).

Për çka tjetër do të dëshironit të flisnim, a mjafton kaq?

Ebru Süleyman: Nëse dëshironi të më tregoni diçka, unë po ju dëgjoj.

Mürteza Büşra: Shpresoj që nuk do të mbetet me kaq, ejani prapë, ejani vitin tjetër, mund të elaborojmë dhe të flasim pak më shumë. Nëse ju jeni të lumtur me këtë edhe unë jam i lumtur. Paçi fat me transmetimin tuaj dhe punën.

Ebru Süleyman: Ju faleminderit shumë.